



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 16 dhjetor 2019
Nr. ref.:RK1488/19

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI62/19

Parashtrues

Gani Gashi

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, GSK-KPA-A-243/15, të 4 dhjetorit 2018

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Gani Gashi, nga Prishtina (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesi i kërkesës), i përfaqësuar nga Sabri Ademi, avokat nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës [GSK-KPA-A-243/15], të 4 dhjetorit 2018, të cilin parashtruesi i kërkesës e ka pranuar më 12 shkurt 2019.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, me të cilin parashtruesi i kërkesës pretendon se i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], paragrafët 1 dhe 7 të Kushtetutës, në nenin 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa Individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 15 prill 2019, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 16 prill 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Radomir Laban gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bekim Sejdiu (kryesues), Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi.
7. Më 6 maj 2019, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën ditë, Gjykata e njoftoi Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ajo që të dorëzonte në Gjykatë fletëkthesën që dëshmon se kur parashtruesi i kërkesës e ka pranuar vendimin e kontestuar.
8. Më 18 korrik 2019, Gjykata ripërsëriti kërkesën në Gjykatën Supreme, ku kërkoi që të dorëzonte në Gjykatë fletëkthesën që dëshmon se kur parashtruesi i kërkesës e ka pranuar vendimin e kontestuar.
9. Gjykata Supreme e Kosovës, nuk ka dorëzuar asnjë përgjigje lidhur me kërkesën e Gjykatës.
10. Më 18 korrik 2019, Gjykata kërkoi nga parashtruesi i kërkesës që të dorëzonte në Gjykatë fletëkthesën që dëshmon se kur e ka pranuar vendimin e kontestuar si dhe disa vendime të gjykatave të rregullta.
11. Më 19 korrik 2019, Gjykata Supreme e Kosovës dorëzoi në Gjykatë dokumentin e kërkuar.

12. Më 6 gusht 2019, parashtruesi i kërkesës i dorëzoi në Gjykatë dokumentet e kërkuara.
13. Më 13 nëntor 2019, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

Procedura përkitazi me ndarjen e banesës, e cila ka rezultuar me Vendim të formës së prerë

14. Më 10 mars 1999, Komisioni për Çështje Banesore i ish-Entit për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës të Kosovës, përmes Vendimit [nr. 69], i kishte ndarë B. M. si punëtorë i kësaj ndërmarrje një banesë e cila gjendet në lagjen Bregu i Diellit, në Prishtinë. Parashtruesi i kërkesës pohon se Komisioni për Çështje Banesore i ish-Entit për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës të Kosovës, të njëjtën ditë kur e ka mbajtur mbledhjen e ka bërë edhe ranglistën e pikëve për kandidatët potencial, duke e ranguar B. M. me 94.5 të pikëve në vendin e parë si përfitues, ndërsa parashtruesin e kërkesës e kishte ranguar me 91 pikë.
15. Më 22 mars 1999, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur ankesë në Këshillin Drejtues të ish-Entit për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës të Kosovës - si organ i shkallës së dytë, kundër Vendimit të lartpërmendur, duke pretenduar se kjo banesë është ndarë në baza diskriminuese etnike dhe për më tepër për një gjë të tillë nuk ishte respektuar asnjë kriter ligjor.
16. Parashtruesi i kërkesës nuk kishte marrë asnjëherë përgjigje në ankesën e tij nga organi i lartpërmendur.
17. Më 7 qershor 2001, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur padi në Gjykatën Komunale në Prishtinë, për anulimin e Vendimit me [nr. 69], të 10 marsit 1999, të lëshuar nga ish-Enti për Mbrojtjen e Monumenteve Kulturore të Kosovës.
18. Më 19 qershor 2003, Gjykata Komunale në Prishtinë, përmes Aktvendimit [C. nr. 642/2001], kishte ndërprerë procedurën lidhur me këtë çështje, me arsyetimin se për të njëjtën çështje është duke u zhvilluar procedura pranë Komisionit për Çështje Pronësore Banesore (në tekstin e mëtejme KÇPB) pasi që e njëjta kishte juridiksion për pronën kontestuese.
19. Nga shkresat e lëndës, vërehet se pranë KÇPB-së paralelisht kishin ushtruar ankesë parashtruesi i kërkesës duke pretenduar të drejta pronësore mbi pronën kontestuese si dhe M. B. i cili kishte theksuar se mundësinë për të ushtruar të drejtën e tij pronësore e kishte humbur për shkak të rrethanave që kanë ndodhur gjatë periudhës 1998/1999.
20. Më 28 shtator 2004, KÇPB, përmes Vendimit [HPCC/D/130/2004/A], kishte refuzuar kërkesat e parashtruesit të kërkesës dhe të M. B., duke theksuar se asnjëra nga palët nuk ka dëshmuar të drejtën e vlefshme pronësore në pronën kontestuese.

21. Parashtruesi i kërkesës dhe M. B. kishin paraqitur kërkesë për rishqyrtim të Vendimit [HPCC/D/130/2004/A] të KÇPB –së, të 28 shtatorit 2004, në KÇPB.
22. Më 30 gusht 2006, KÇPB, përmes Vendimit [HPCC/REC/66/2006], kishte refuzuar kërkesën e parashtruesit të kërkesës dhe të M. B., si të pabazuara me arsyetimin se asnjëra palë nuk kishte dëshmuar mjaftueshëm të drejtën e tyre pronësore në pronën kontestuese.
23. Vendimi ishte bërë *res judikata* më 27 shtator 2006.

Përkitazi me procedurën e dytë gjyqësore

24. Më 22 dhjetor 2007, S. D. në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare M. B., si bartës i pretenduar i të drejtës pronësore, kishte parashtruar kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (në tekstin e mëtejme: AKP) duke kërkuar riposelimin e pronës kontestuese.
25. Më 22 shkurt 2008, AKP-ja kishte bërë identifikimin fizik të pronës dhe rezultoi se e njëjta është uzurpuar nga parashtruesi i kërkesës.
26. Parashtruesi i kërkesës, në cilësinë e palës përgjegjëse në kërkesë, në mbështetje të pretendimit të tij, kishte dorëzuar disa dokumente të cilat ai i konsideronte relevante për rastin e tij si dhe ndër të tjera kishte theksuar se prona kontestuese i ishte ndarë nga punëdhënësi i tij, Instituti i Kosovës për mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës.
27. Më 21 tetor 2014, Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KKPK), përmes Vendimit [KPPC/D/R/263/2014], hodhi poshtë kërkesën e S. D. duke theksuar se kjo çështje është çështje e gjykuar (*res judikata*). Në arsyetimin e vendimit grupor, ndër të tjera, theksohet se “*e njëjta kërkesë e saj për të njëjtën banesë nga provat e dorëzuara nga palët dhe të siguruar ex officio rezulton se kjo çështje ishte vendosur me vendim të formës së prerë*”.
28. Më 20 janar 2015, parashtruesi i kërkesës pasi kishte pranuar vendimin e lartpërmendur, kishte parashtruar ankesë në Gjykatën Supreme kundër tij, duke pretenduar se banesa e cila i është ndarë M. B. i është ndarë në mënyrë të kundërligjshme sepse, sipas tij, i njëjti nuk i ka plotësuar kushtet formale për një gjë të tillë.
29. Më 4 dhjetor 2018, Gjykata Supreme e Kosovës, përmes Aktgjykimit [GSK-KPA-A-243/15], refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi Vendimin [KPPC/D/R/263/2014], të 21 tetorit 2014, të KKPK-së. Gjykata Supreme në Aktgjykimin e saj theksoi se “*Vendimi KPPC/D/R/263/2014, të 21 tetorit 2014 KKPK, ishte i drejtë dhe ligjor, brenda kufijve dhe juridiksionit dhe kompetencave të KKPK-së, sepse çështja është res judikata, sepse ndërlidhet me palët e njëjta, pronën e njëjtë dhe kontekst ligjor*”.

të njëjtë të vendosur më herët me Vendimin HPCC/REC/66/2006, të 30 gushtit 2016, të KKPK-së”.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

30. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se me vendimin e kontestuar i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës.

(i) Pretendimet e parashtruesit lidhur me procedurën e parë që ka rezultuar me vendim të formës së prerë

31. Parashtruesi i kërkesës pretendon se *“Konsideroj se ndaj meje është shkelur neni 24 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, meqë unë nuk kam qenë i barabart para ligjit sepse me asnjë dispozitë ligjore, nuk ka mundësi që kur vendoset për ndarjen e një banese për punëtor, që në të njëjtën ditë nga komisioni për çështje banesore, të njëjtën ditë të bëj ranglistën e poenëve dhe menjëherë po me të njëjtën datë njërit prej tyre t’i lëshohet edhe vendimi mbi ndarjen e banesës, pa u qit ranglista në tabelën e shpalljeve dhe pa u lënë mundësia e ankesës, këto vërejte fare nuk i ka marrë parasysh dhe as më është përgjigjur komisioni i shkallës së dytë pranë të cilit kam parashtruar kundërshtim me shkrim [...] prandaj një vendim i tillë është i paligjshëm dhe diskriminues në raport me mua si shqiptar është dashur që të anulohet dhe të obligohet Instituti ku punoj ta bëjë ndarjen e sërishme të asaj banese në mënyrë të drejtë [...]”.*

(ii) Pretendimet e parashtruesit përkitazi me procedurën e dytë gjyqësore

32. Parashtruesi i kërkesës po ashtu pretendon se *“Gjykata Supreme e Kosovës në bazë të Aktgjykimit GSK-KPA-A-203/15 e ka refuzuar ankesën time duke mos i marrë për bazë pretendimet e mija të drejta dhe të ligjshme”.*

33. Parashtruesi i kërkesës përfundon duke kërkuar që Gjykata të shpallë të pavlefshëm vendimin e kontestuar.

Pranueshmëria e kërkesës

34. Gjykata do të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

35. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

36. Në vazhdim, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohet në Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet neneve 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

1. *Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.*
2. *Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të këtë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.*

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor [...]”.

37. Sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, e cila konteston një akt të një autoriteti publik, pas shterimit të të gjitha mjeteve juridike. Parashtruesi i kërkesës i ka sqaruar të drejtat dhe liritë që pretendon se i janë shkelur me vendimin e kontestuar, në pajtim me kushtet nga neni 48 i Ligjit dhe e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatin e përcaktuar në nenin 49 të Ligjit.
38. Gjykata në bazë të shkresave të lëndës dhe pretendimeve të parashtruesit konstatoi se ishin zhvilluar dy procedura në gjykatat e rregullta dhe që të dy procedurat kishin rezultuar me vendime të formës së prerë.
39. Gjykata vëren se, në thelb, parashtruesi ngritë pretendime kushtetuese në lidhje me të dy procedurat.
40. Prandaj, Gjykata gjatë shqyrtimit të mëtejme nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, do t'i trajtojë këto dy pretendime ndaras.
- (i) *Sa i përket pretendimeve të parashtruesit të kërkesës lidhur me procedurën e parë e cila ka rezultuar me vendimin e formës së prerë*
41. Fillimisht, Gjykata duhet të vlerësojë nëse janë plotësuar kriteret e parapara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës, duke

përfshirë kushtin e paraparë me rregullin 39 (3) (d) i Rregullores së punës, përcakton se:

“Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të papranueshme nëse ndonjë nga kushtet në vijim është i pranishëm”.

(d) kërkesa nuk është ratione temporis në pajtim me Kushtetutën;

42. Përkitazi me pretendimin e parashtruesit të kërkesës në lidhje me këtë procedurë, ai pretendon se i është shkelur barazia para ligjit, sepse sipas tij ai nuk ka qenë i barabartë para ligjit, për shkak se Vendimi [nr. 69] i Komisionit për Çështje Banesore i ish-Entit për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës të Kosovës, i 10 marsit 1999, në bazë të të cilit M. B. i ishte ndarë banesa e cila është objekt i kontestit, është diskriminues në baza etnike.
43. Lidhur me këtë, Gjykata vëren se procedura e parë ka filluar në vitin 2001, kur parashtruesi i kërkesës kishte ngritur padi në Gjykatën Komunale dhe ka përfunduar më 30 gusht 2006 me Vendimin [HPCC/REC/66/2006] të KCPB-së, i cili ishte bërë i formës së prerë, ku është zgjidhur kontesti lëndor i kësaj kërkesë.
44. Gjykata konkludon se veprimet dhe vendimet në lidhje me procedurën e parë të parashtruesit janë zhvilluar në rrethana të ndryshme dhe në kohë kur Gjykata nuk kishte juridiksion kohor, dhe si të tilla nuk janë *ratione temporis* në pajtim me Kushtetutën, e cila hyri në fuqi më 15 qershor 2008 (shih, për shembull, rastin nr. KI47/14 parashtruesi i kërkesës *Mustaf Zejnullahu*, Aktvendimi për papranueshmërinë, i 11 gushtit 2014, paragrafi 25)
45. Prandaj, në pajtim me rregullin 39 (3) (d) të Rregullores së punës, Gjykata konstaton se kërkesa në lidhje me pretendimin e parashtruesit të kërkesës që ndërlidhet me procedurën e parë gjyqësore, duhet të shpallet e papranueshme sepse nuk është *ratione temporis* në pajtim me Kushtetutën.

(ii) Sa i përket pretendimeve lidhur me procedurën e dytë gjyqësore

46. Lidhur me këtë pretendim, Gjykata duhet të vlerësojë më tej nëse janë plotësuar kriteret e parapara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës, duke përfshirë kushtin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Kështu, rregulli 39 (2) i Rregullores së punës, përcakton se:

“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetet në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

47. Sa i përket procedurës së dytë, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës në thelb pretendon se Gjykata Supreme nuk i kishte marrë parasysht pretendimet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës.
48. Gjykata vëren se esenca e pretendimeve të parashtruesit ka të bëjë me konstatim të gabuar të gjendjes faktike nga ana e Gjykatës Supreme.

49. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës, të njëjtat pretendime i ka paraqitur edhe në ankesën e tij në Gjykatën Supreme.
50. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se Aktgjykimi [GSK-KPA-A-243-15] i 4 dhjetorit 2018, i Gjykatës Supreme, adresoi dhe vendosi për pretendimet e lartpërmendura, të cilat tashmë ishin ngritur nga parashtruesi i kërkesës.
51. Gjykata rikujton se Gjykata Supreme, refuzoi ankesën e parashtruesit kundër Vendimit KPPC/D/R/263/2014, të KKPK-së të 21 tetorit 2014, sepse çështja ishte *res judicata*, pasi që kishte të bënte me palët e njëjta, pronën e njëjtë dhe kontest ligjor të njëjtë dhe për më tepër parashtruesi i kërkesës ndonëse ka pretenduar të drejtën ligjore mbi pronën kontestuese, nuk e ka kundërshtuar apo argumentuar me asnjë provë të vlefshme vendimin e lartpërmendur.
52. Lidhur me këtë, Gjykata i referohet Aktgjykimit GSK-KPA-A-243/15, të Gjykatës Supreme e cila arsyetoi “*Nuk janë të qëndrueshme theksimet në ankesë të palës ankuese dhe të palës përgjegjëse në ankesë [...] andaj ankesa refuzohet si e pabazuar sepse KKPK-ja me vendimin e saj të ankimuar nuk ka vendosur lidhur me zgjidhjen e çështjes në mënyrë meritore, sepse çështja në mënyrë meritore është vendosur më herët sipas vendimeve të cekura nga Komisioni për çështje banesore pronësore të Vendimit HPCC/D/130/2004/A i dt 28.09.2004) dhe i shkallës së dytë, HPCC/REC/66/2006, të datës 30 gusht 2006*”. Më tutje, Gjykata Supreme ka theksuar se KKPK-ja ka vendosur në mënyrë të drejtë dhe se parashtruesi i kërkesës nuk e ka kundërshtuar apo argumentuar me ndonjë provë të vlefshme përmbajtjen e tij”.
53. Gjykata konsideron se, në bazë të fakteve të këtij rasti, të cilat rrjedhin nga dokumentet e prezantuara dhe nga pretendimet ankimore të parashtruesit të kërkesës, Gjykata Supreme ka arsyetuar mjaftueshëm vendimin e vet, duke përfshirë edhe arsyet mbi të cilat e refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës.
54. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk pajtohet me rezultatin e procedurave në gjykatat e rregullta, duke kontestuar vlerësimin e provave dhe vërtetimin e fakteve nga ana e këtyre gjykatave.
55. Gjykata rikujton se fakti i thjeshtë se parashtruesi i kërkesës nuk është i kënaqur me rezultatin e vendimeve të Gjykatës Supreme apo përmendja e neneve të Kushtetutës, nuk është e mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (shih, *mutatis mutandis*, rastin e Gjykatës Kushtetuese KI136/14, *Abdullah Bajqinca*, Aktvendim për papranueshmëri, i 10 shkurtit 2015, paragrafi 33).
56. Lidhur me këtë, Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese që të merret me gabimet e faktit ose të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta gjatë vlerësimit të provave apo zbatimit të ligjit (ligjshmëria), përveç dhe për aq sa ato të mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria).

57. Është detyrë e gjykatave të rregullta që të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, *Garcia Ruiz kundër Spanjës* [DHM], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut [GJEDNJ] 1999-I, rasti i Gjykatës Kushtetuese KI86/11, parashtrues i kërkesës *Milaim Berisha*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 prillit 2012).
58. Gjykata Kushtetuese rikujton se nuk është gjykatë e gjetjes së fakteve dhe se vërtetimi i drejtë dhe i plotë i gjendjes faktike është brenda juridiksionit të plotë të gjykatave të rregullta. Roli i Gjykatës Kushtetuese është vetëm që të sigurojë respektimin e standardeve kushtetuese gjatë procedurave gjyqësore në gjykatat e rregullta, prandaj, nuk mund të veprojë si “gjykatë e shkallës së katërt” (shih, rastin e GJEDNJ-së, *García Ruiz kundër Spanjës*, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 28; dhe shih, gjithashtu ndër të tjera, rastet e Gjykatës: KI70/11, parashtrues të kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011, paragrafi 29; KIO6/17, parashtrues *L. G. dhe pesë të tjerët*, paragrafi 37).
59. Fakti se parashtruesi i kërkesës nuk pajtohet me rezultatin e rastit nuk mund të ngrejë vetvetiu një pretendim të argumentuar për shkelje të të drejtave dhe lirive të garantuara me Kushtetutë dhe Konventë (shih rastin e Gjykatës nr. KI125/11, *Shaban Gojnovci*, Aktvendim për papranueshmëri, i 28 majit 2012, paragrafi 28).
60. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk e ka mbështetur pretendimin e tij, lidhur me vërtetimin e të drejtës pronësore mbi banesën e cila gjendet në Prishtinë.
61. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe deklarohet e papranueshme në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

Përfundim

62. Lidhur me pretendimin e parë të parashtruesit të kërkesës lidhur me procedurën e parë e cila ka rezultuar me vendimin e formës së prerë, Gjykata konstaton se, në pajtim me rregullin 39 (3) (d), kërkesa duhet të shpallet e papranueshme sepse nuk është *ratione temporis* në pajtim me Kushtetutën.
63. Lidhur me pretendimin e dytë të parashtruesit të kërkesës që ndërlidhet me procedurën e dytë gjyqësore, kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe deklarohet e papranueshme në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, dhe rregullit 39 (2) dhe 3 (d) të Rregullores së punës, më 13 nëntor 2019, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Radomir Laban



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi